

REPublika e Kosovës / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISË MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njësia Org. Org. Jedin Org. Unit	Nr. Prof. Br. Prof. Prof.No:
Nr. fazeve Broj stranica No. pages	Data: Datum: Date:
02	3043
3	24.11.22
PRISHTINË/A	NO-1



Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije
Ministry of Economy



KOMUNA E LIPJANIT



OPRE ROMA KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Pranuar me: Prilježeno:	29.11.2022	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
3-551/01-63650		

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

E LIDHUR

NË MES TË

MINISTRISË SË EKONOMISË

KOMUNËS SË LIPJANIT- DREJTORIA E PUNËS DHE MIRËQENIES
SOCIALE

DHE

“OPRE ROMA KOSOVO”

Duke marrë parasysh masat e emergjencës në furnizimin me energji me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.1800/3 të datës 09.08.2022 për miratimin e Vendimit Nr. 01/91 të datës 31.07.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 04/97 të datës 20.09.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbështetjen në tejkalimin e krizës energjetike,

Bazuar në thirrjen publike të Ministrisë së Ekonomisë për subvencionim të efijencës së energjisë për qytetaret, me Nr.2402 të datës 10.10.2022,

Palët, pajtohen si në vijim:

Neni 1
Qëllimi

Ky Memorandum Mirëkuptimi ka për qëllim bashkëpunimin në mes të Ministrisë së Ekonomisë, Komunës së Lipjanit – Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe “Opre Roma Kosova” lidhur me mbështetjen e komunitetit rom, duke ofruar ndihmën e nevojshme gjatë hapjes së E-



mail-adresave, regjistrimit në platformën e-Kosova dhe Aplikimet në fazën I & II për të përfituar nga subvencionimi për efikasitet të energjisë.

Neni 2


Obligimet dhe përgjegjësitë e “Opre Roma Kosovo”

1. “Opre Roma Kosovo” do të ndihmojë, familjet e komunitetit Rom, por edhe qytetarë tjerë në nevojë, që t’iu lehtësojë procedurat e subvencionit të efikasitetit të energjisë nga Ministria e Ekonomisë për aplikim përmes ofrimit të kapaciteteve njerëzore pranë Qendrave për Punë Sociale që ofrojnë shërbime në 11 komuna si: Prizren, Gjakova, Obiliq, Graçanicë, Peja, Mitrovicë Jugore dhe Veriore, Fushë Kosova, Lipjan, Kamenica, Gjilan.
2. “Opre Roma Kosovo” përmes aktivistëve pajtohet të bashkëpunojë dhe të ofrojë asistencë qytetarëve në nevojë që nga hapja e E-mail Adresave, regjistrimit në e-Kosova e deri në aplikimet në dy fazat.
3. “Opre Roma Kosovo” mund të ofrojë asistencë tjetër si:
 - 3.1. Mbështetje direkte familjeve gjatë gjithë procedurës të aplikimit;
 - 3.2. Mbështetje me staf shtesë për zyre që mund të krijohen për aplikim, në nivel komunal;
 - 3.3. Vizita e familjeve dhe mbështetje në procedurë;
 - 3.4. Ndihmë logjistike në blerje;
 - 3.5. Mbulesë të përqindjes së kontributit familjar për së paku 100 familje të identifikuara për nevojë, me mundësi të rritjes së numrit të të mbështeturëve;
 - 3.6. Ndihmë në marrëveshje me kompaninë që mund të ofrojnë shporeta duke e pritur rimbursimin e mjeteve nga Qeveria.

Neni 3

Obligimet dhe Përgjegjësitë

Ministria e Ekonomisë dhe Drejtoria për Mirëqenie Sociale darkordohen që përmes Qendrave për Punë Sociale (QPS) që veprojnë dhe ofrojnë shërbime në kuadër të Komunave përkatëse si Prizreni, Gjakova, Obiliq, Graçanicë, Peja, Mitrovicë Jugore dhe Veriore, Fushë Kosova, Lipjan, Kamenica, Gjilan të sigurojnë kushtet të nevojshme për punë, si: sigurimin e hapësirës për punë dhe mjetet tjera të domosdoshme për kryerjen e detyrave të punës të përcaktuar me marrëveshje për aktivistet e Opre Roma Kosovo.



Neni 4

Angazhimi i Aktivistëve të “Opre Roma Kosovo” bëhet në periudhë deri në përfundim të Thirrjes Publike për subvencionim të efikasitetit të energjisë, si dhe bëhet në baza vullnetare dhe ky Memorandum Mirëkuptimi nuk përbën implikime financiare për palët.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Palët.

Për:

Ministria e Ekonomisë:

Leonita Shabani

Zv.Sekretare e Përgjithshme



Për:

Opre Roma Kosovo

Driton Berisha

Përfaqësues

Nënshkrimi:

Prishtinë, 23.11.2022

Për:

Komunën e Lipjanit

Drejtoria e Punës

dhe

Mirëqenies Sociale

Emri:

